

Autobiografi për Kudusi Halit LAMA

**Emri Kudusi
Babai Halit
Mbiemri LAMA**



**Grada shkencore
Doktor i Shkencave Ushtarake,**

**Grada ushtarake
Gjeneral Brigade,**

**Specialiteti
Në armën e Artilerisë Tokësore**

Quhem Kudusi LAMA, i biri i Halitit dhe Mihanës dhe kam lindur në fshatin Gështenjë të Kalisit, në krahinën e Lumës, në rrethin e Kukësit me 09.05.1951

Më 1954 më ka vdekur babai duke më lënë jetim. Më ka rritur nëna. Kam një vëlla që trashëgon emrin e babait, pasi ka lindur 3 muaj, pasi ka vdekur babai dhe një motër që është më e madhe se unë.

Jam rritur nën kujdesin e pa ndërprerë të nënës Mihane.

Shkollën fillore e kam kryer në fshatin tim të lindjes në Gështenjë me 1958 deri 1962. Ndërsa shkollën 7 vjeçare e kam kryer në Kalis me 1962 deri 1965.

Shkollën e mesme për “Agronomi” e kam kryer në Peshkopi prej 1965 deri 1969.

Në vitin 1969 deri me 1970, kam punuar si agronom në Kooperativë Bujqësore në Kalis e Ujmisht të rrethit Kukës.

Më 1970 deri më 1972 kam kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” në Tiranë, në Specialitetin Artileri Tokësore dhe jam titulluar oficer aktiv i ushtrisë më 30 Korrik 1972.

Kështu karriera ime ushtarake filloi më 1972, dhe prej asaj kohe kam pasur këtë ecuri në detyra:

- 1972 deri 1976 kam kryer detyrën e Shefit të Zbulimit të Artilerisë së Brigadës së Këmbësisë në Kavajë,
- 1976 deri 1983 kam kryer detyrën e Komandantit të Grupit të Artilerisë në Brigadën e Këmbësisë në Kukës,
- Prej 1983 deri më 1985, kam vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake në Tiranë, (sot Akademia e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura).
- Më 1985 deri 1992 jam emëruar dhe kam kryer detyrën e Specialistit për artilerinë në shtabin e divizionit, në Divizionin e Këmbësisë në Kukës,
- 1992 deri 1997 kam kryer detyrën e Specialistit të artilerisë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në Tiranë,
- 1997 deri 1999 kam kryer detyrën e Komandantit të Divizionit të Këmbësisë në Kukës,
- 1999 deri 2000 kam kryer detyrën e Komandantit të Divizionit të Këmbësisë në Tiranë,
- Nga viti 2000 deri më 2006, kam kryer detyrën e Komandantit të Komandës së Mbështetjes Logjistike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Tiranë.

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, më 21 Qershor 2006 kam dorëzuar detyrën dhe kam dalë në rezervë.

Me 20 Korrik 1996, kam mbrojtur disertacionin dhe kam marrë gradën **Doktor i Shkencave Ushtarake**.

Tema e disertacionit: **“Disa dukuri të përdorimit luftarak të artilerisë dhe drejtimit të zjarrit të saj në kushtet e dimrit në terren malor”** është lëvruar në këtë shkallë për herë të parë, si domosdoshmëri e kohës, për kushtet që u krijuan në teatrin shqiptar të përgatitjes për luftë.

Gradën e Gjeneralit të Brigadës e kam marrë më 12 mars 1997.

Gjatë jetës jam dekoruar me:

- 2 medalje të shërbimit ushtarak,
- 1 urdhër të shërbimit ushtarak të klasit të tretë,
- 1 medalje të artë të shqiponjës,
- 1 medalje të mirënjohjes,
- 1 medalje të argjendtë nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të Shqipërisë,
- 1 urdhrin “Adem Jashari” nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës.
- 1 Medalje Për Shërbime Ushtarake,
- 3 urdhra e medalje nga ministri i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë,
- 4 urdhra e medalje nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Jam vlerësuar dhe nderuar:

- Nga Komuna e Prizrenit me titullin “Qytetar Nderi i Qytetit të Prizrenit”;
- Nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të Shqipërisë, me Titullin “Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ”;
- Nga Komuna e Rahovecit me titullin “Qytetar nderi i Komunës së Rahovecit”;
- Nga Shoqata “BYTYÇI” me titullin “Trim mbi Trimat”;
- Nga Instituti Albanologjik në Prishtinë me titullin “Anëtar Nderi i Institutit Albanologjik”
- Nga Shoqata “Atdheu” në Bad Ragaz, në Zvicër, “Anëtar Nderi i Shoqatës”;
- Nga Organizata e Veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës në Prizren me titullin “Gjeneral i Ushtrisë së Përvjetshme”;
- Nga Familja Jashari në Prekaz me medaljonin “Adem Jashari”;
- Nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare Preshevë – Metvegje – Bujanoc, me mirënjohje të posaçme;
- Nga Komuna e Vushtrrisë me Mirënjohje;
- Po kështu me mirënjohje nga shumë struktura të tjera në Kosovë e Maqedoni.

Jam veteran lufte i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Angazhimi im në Luftën Çlirimtare të Kosovës fillon në fillim të Majit 1997 dhe ka vijuar pa ndërprerë deri në përfundimin e saj. Gjatë luftës jam angazhuar me të gjitha veprimtaritë e mundshme në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe me krerët e saj Xhavit Haliti, Azem Syla, Xheladin Gashi, Bislim Zyrapi, Agim Çeku, Ali Ahmeti, Jashar Saliu, Nasim Haradinaj, si dhe me anëtarë të tjerë të udhëheqjes, me komandantë të të gjitha niveleve dhe me kolektiva luftëtarësh në momente të veçanta. Aktiviteti im shtrihet që të organizim, planëzim, trajnim, furnizim, akomodim e deri në vijat e frontit, ku kam pasur rastet e lumtura të jem në rolin e luftëtarit të thjeshtë të frontit.

Gjatë periudhës 1997 – 1999, kam qenë komandant i Divizionit të Këmbësisë në Kukës. Për mua në atë periudhë ka qenë vërtetë luftë dhe trupat që kam drejtuar e komanduar kanë marrë pjesë direkt në luftë, pasi divizioni i Këmbësisë në Kukës, ka zhvilluar një mori betejash me ushtrinë serbe, kuptohet jo për faj të tij, por për arsye të imponuara nga serbët. Megjithatë këto beteja e ndeshje pavarësisht si vlerësohen kanë zgjatur nga 3 orë deri në tre ditë secila dhe janë jo pak por 39 të tilla, në një hapësirë kohore 22 mujore, aq sa ka zgjatur edhe Lufta Çlirimtare e Kosovës si luftë e hapur dhe e identifikuar si e tillë.

Në vitin 2002 kam kryer Kolegjin e Mbrojtjes në Tiranë.

Në vitin 2005 kam kryer Akademinë Diplomatike në Tiranë.

Jam i martuar dhe kam 5 fëmijë. Sot banoj në Marikaj, Tiranë.

Për zhvillimin e mendimit ushtarak shqiptar kam dhënë kontribute të vazhdueshme. Jam marrë në vijimësi me veprimtari studimore e

shkencore, duke qenë pjesëmarrës në mjaft veprimtari në shkallë brigade, korpusi, divizioni dhe ushtrie.

Në sesionet shkencore të njësisë dhe ato në shkallë ushtrie, jam paraqitur me një bagazh të konsiderueshëm studimor, ku, nëpërmjet mjaft studimeve të paraqitura e shkrimeve në shtypin ushtarak, si dhe studimeve të posaçme kam trajtuar dhe argumentuar një sërë problemesh të përdorimit të trupave, prej të cilëve veçoj:

1. “Përdorimi i Grupit të gatshëm të autobusëve në luftim”, në Kukës, me 1978, në përbërje të BrK Kukës (reparti ushtarak nr. 6600).
2. “Drejtimi i Zjarrit të grupit të gatshëm të autobusëve në bashkëveprim me Skuadrat e Korrigjimit të Zjarrit të Artilerisë në çetat vullnetare” në Kukës, më 1979, në përbërje të BrK Kukës (reparti ushtarak nr. 6600).
3. “Drejtimi i Zjarrit të artilerisë së batalionit me metodat e thjeshta”, në Kukës, me 1987, në përbërje të DK Kukës (reparti ushtarak nr. 1244).
4. “Drejtimi i Zjarrit të artilerisë në terren malor në kushtet e dimrit”, në Kukës, me 1988, në përbërje të DK Kukës (reparti ushtarak nr. 1244). etj

Në punën time studimore, kam kryer edhe një sërë eksperimentesh (stërvitje treguese, metodika, etj) me karakter tregues dhe eksperimental, siç janë ato për përdorimin luftarak të artilerisë e drejtimin e zjarrit të saj në kushte të ndryshme të terrenit e të motit.

Prej tyre duke mos i anashkaluar stërvitjet në kushtet e dimrit në divizionin e Kukësit në vitet 1988 – 1989, e shumë të tjera, nga stërvitjet e mëdha që kam planëzuar, organizuar, udhëhequr dhe realizuar, veçoj:

1. stërvitjen me trupa me qitje luftarake në Voskopojë në vitin 1995, ku trupat u vendosen plotësisht në kushte reale lufte, me përdorimin e të gjitha llojeve të armëve. Stërvitja ishte me Temë: “Batalioni i këmbësisë në mbrojtje me qitje luftarake me përdorimin e të gjitha llojeve të armëve” dhe mbështetjen me zjarrin e dy grupeve të artilerisë të kalibrit të rëndë, të tankeve, flakëhedhësve, artilerisë kundër ajrore etj, me përdorimin e metodave perëndimore të korrigjimit të zjarrit të artilerisë.

2. stërvitjen me trupa me qitje luftarake në Palavli, në Delvinë në vitin 1996, ku trupat u vendosën plotësisht në kushte reale lufte, me përdorimin e të gjitha llojeve të armëve. Stërvitja ishte me Temë: “Batalioni i këmbësisë në mësimje me qitje luftarake me përdorimin e të gjitha llojeve të armëve” dhe mbështetjen me zjarrin e dy grupeve të artilerisë të kalibrit të rëndë, të tankeve, flakëhedhësve, artilerisë kundër ajrore etj, me përdorimin e metodave perëndimore të korrigjimit të zjarrit të artilerisë.

Kam marrë pjesë, si bashkautor, në komisionet e hartimit të rregulloreve të luftimit të artilerisë, teksteve mësimore për stërvitjen e ushtarëve të artilerisë, leksioneve, të ndryshme për artilerinë, përdorimin e trupave gjitharmëshe në operacion dhe përdorimin e logjistikës në

kushtet e paqes, krizave dhe luftës, në hartimin e Doktrinës së Logjistikës, në hartimin e Politikës së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Strategjisë së Sigurimit dhe Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

Kam marrë pjesë në një seri konferencash shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ku jam paraqitur me kumtesa, që janë botuar edhe në revistat shkencore në Kosovë dhe në Maqedoni, për probleme të sigurisë, të gjeopolitikës, të zgjidhjes së konflikteve, të menaxhimit të emergjencave, të menaxhimit të personelit, për probleme historike, etj.

Në fushën e botimeve, kam botuar një sërë artikujsh përgjithësues dhe metodik në shtypin ushtarak të kohës, kryesisht për problemet e përgatitjes speciale dhe të përdorimit me efektivitet të artilerisë në luftim, të luftimit e operacionit gjitharmësh, për logjistikën, për organizimin ushtarak etj.

Kam botuar dhe vazhdoi të botoj një mori artikujsh e analizash politike e historike në shtypin aktual në Tiranë dhe në Prishtinë.

Kam botuar librat:

1. "KOSOVA DHE USHTRIA ÇLIRIMTARE" në vitin 2005,
2. "Ilir Shaqiri – Heroizëm dhe Dashuri" në vitin 2012,
3. "Hyrje në Menaxhimin e Emergjencave" në vitin 2012,
4. "Vlerat e Luftës Çlirimtare të Kosovës për mbrojtjen e çështjes kombëtare" në vitin 2012,
5. "Menaxhimi i Emergjencave" në vitin 2013,
6. "Menaxhimi i Planeve të Emergjencave" në vitin 2014,
7. "Fjalor Shpjegues i termave të menaxhimit të emergjencave" ku jam bashkautorë, në vitin 2015,
8. "Analiza dhe Vlerësimi i Rreziqeve", në vitin 2016,
9. "Nëna ime Mihane Lama", në vitin 2018, si dhe vijoj për punimin e botimin e një seri veprash të tjera.

Gjatë viteve 1987 – 1991, kam dhënë me rezultatin "shumë mirë e mire" katër provimet pasuniversitare, (Filozofi e Gjuhë Ruse në Universitetin e Tiranës, Arti Ushtarak dhe Arti i përdorimit të artilerisë në Akademinë Ushtarake), ndërkohë që përgatisja temën e disertacionit, të cilën e përfundova plotësisht më 1996 dhe më 20.07.1996 e mbrojta atë para Komisionit të Posaçëm, të Artit Ushtarak, sipas vendimit të Komisionit të Kualifikimit Shkencor të Republikës së Shqipërisë, pranë Këshillit të Ministrave.

Deri tani nuk aderoj në asnjë parti politike.

Në periudhën 2006 – 2009 – kam punuar si pedagog në "Universitetin e Prizrenit", në Prizren – duke ligjëruar lëndët:

- Politika e Sigurisë,
- Diplomaci,
- Gjeopolitike.

2008 – 2009 – pedagog në “Universitetin Iliria” në Prishtinë – duke ligjëruar lëndët

- Politika e Sigurisë,
- Zgjidhja e Konflikteve,

2007 – e në vazhdim – pedagog në Kolegjin “BIZNESI” në Prishtinë – duke ligjëruar lëndët

- Hyrje në Menaxhimin e Emergjencave, (bahceler)
- Menaxhimi i emergjencave, (bahceler)
- Kërkim – shpëtimi në emergjenca, (bahceler)
- Dinamika për mbrojtje nga fatkeqësitë, (bahceler)
- Hyrje në Politikën e Sigurisë, (bahceler)
- Partneriteti Strategjik, (bahceler)
- Trajnimi për menaxhimin e sigurisë, (bahceler)
- Menaxhimi i Rreziqeve, (bahceler)
- Menaxhimi i Planeve të Emergjencave, (Master)
- Planëzimi i operacioneve të Emergjencave, (Master)
- Zhvillimi i operacioneve të Emergjencave, (Master)
- Analiza dhe Vlerësimi i Rreziqeve, (Master)
- Menaxhimi i Emergjencave Ndërkombëtare, (Master)

2007 – 2009 – profesor – trajner në “Institutin e Statistikave “Ramil Nuhiu””, në Prishtinë – ku janë mbajtur leksione dhe kurse për modulet:

- Menaxhim i Burimeve Njerëzore,
- Komunikim dhe Administrim Zyre,
- Marrëdhënie ndërkombëtare dhe siguri,
- Politikën e Sigurisë, etj.

2009 – ligjëruar një cikël leksionesh në struktura të Policisë së Kosovës,

2010 dhe 2014 – ligjëruar nga një cikël leksionesh në Komandën e Doktrinaeve në Forcat e Sigurisë së Kosovës,

Në punën time studimore, kam kryer edhe një sërë eksperimentesh me karakter tregues dhe eksperimental.

Prof. Dr. Kudus LAMA,
Gjeneral në Rezervë